33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose njeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektit dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcaktojnë Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arrijtjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrim në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës ose 4,456.02 € me validitet deri më 30.12.2023
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : Dy ditë pas nënshkrimit të kontratës, në konsultim me menaxherin e projektit.
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës 30.11.2023
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahet nga ana e kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni i Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues.

		Menagjer i projektit nga AK eshte: Ylli Qafleshi Menagjer mbikqyres i kontrates nga AK eshte: Behar Brenolli Menagjer i projektit nga OE eshte: Ismail Ahmeti
Pagesa		Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës, kurse pjesa tjetër e pagesës do të realizohet pas përfundimit të punimeve të përcjellura me raport nga ana e menaxherit të kontratës dhe raportit nga ana e komisionit të pranimit teknik të projektit.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagesë paraprake.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: E vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti të lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vlerën e përgjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Oban i
Albania

RREGULLIMI I OBORRIT PARRUT DHE RREGULLIMI I RRUGËS NË QKMF NË DRAGASH					
A	DISLOKIMI I GJENERATORIT ELEKTRIK				
A/1	OBJEKTI I GJENERATORIT ELEKTRIK (3.16x6.16)m				
	Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të rritjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtës dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësirë në mes të zonës për ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtës. Punishtëja të rrethohet me tabela prej llamarinë dhe me konstrukton të forcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve. Për çdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikëqyrës dhe projektantin. Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjashme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.				
I	PUNËT PËRGATITTORE				
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1.1	Sigurimi i punishtës. Sigurimi të bëhet përmes shenjave përkatëse të cilat krijojnë siguri dhe zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sa zgjasin punimet sipas kërkesave të investitorit. Llog. në komplet	komplet	1.00	150.00	150.00 €
1.2	Dislokimi si dhe hartja e Inventarit shkollor, banka, karrike si dhe tabela e zesë në në kthin të objektit të shkollës. Llogarituri në komplet	komplet	1.00	190.00	190.00 €
1.3	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve ekzistuese (ujesjelle, kanalizimi, instalime makineris, instalimet rrymes, instalimet telefonike dhe internetit), pikeletimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimit të dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në trezimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolin të rrjetit ekzistues pastrimin e terent dhe pregaditjen e kushëve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe rinovimin e kthinave të cilat do të trajtohen. Llog. në komplet	komplet	1.00	120.00	120.00 €
Gjithsejt punime pregaditore:					370.00 €

PUNËT DEMOLIMIT, PASTRIMIT, TOKËSORE DHE MBUSILIA					
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
2.1	Pastrimi i mbeturinave të ngurta dhe materialeve të ndryshme që gjenden në vendin ku do të ndërtohet objekti. Materialet largohen në depozitë me të afër legale deri në 10km. Llog. në m2	m ²	28.00	2.00 €	56.00 €
2.2	Demolimi me kujdes të shtuar i pllakës nga beton armehja me makineri ndërtimore, me mjete për thyerje me çekana apo vegla dhe kompresore adekuate, prerje të betonit. Materialet e demoluara largohen në depozitë me të afër legale deri në 10km. Llog. në m2	komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
2.3	Gjerimi i gjerë i dheut në thellësi 30-50cm me makinë në sipërfaqen e cila do të trajtohet për punimin e objekteve. Hapja e themeleve sipas zgjedhjes së parapare me projekt. Në llogarit të merret edhe transporti i dheut të tepërt deri në depozitë të qytetit. Llog. në m ³	m ³	14.00	3.50 €	49.00 €
2.4	Furnizimi, transportimi, planifikimi, shtruarja dhe ngjeshja zhavorit nga guni i thyer me trashësi të shtresës d = 20 cm me saktësi ± 3 cm, nën themele dhe acn pllaken e dyshemesë. Ngjeshja bëhet me cilindër vhrues 12-24 t, densita të arrihet moduli i ngjeshjes N = 7000 KN/m ² . Llog. në m3	m ³	5.60	8.00 €	44.80 €
Gjithsejt punime të demolit, pastrimit dhe tokësore:					349.80 €

III	PUNËT E BETONIT DHE BETONARMES
-----	--------------------------------

POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
	Të gjitha pozicionet e strukturave të betonit duhet të realizohen, sipas dimensioneve, dhe sipas flojt dhe klasës së betonit, dhe atë sipas dokumentacionit Teknik të projektimit, llogaritjes statike dhe detajeve të armimit. Betoni për të gjithë llojet e punimeve duhet të përgaditet, transportohet, punohet, murenbalet dhe testohet sipas parashikimeve të përcaktuara në rregullat e zbatueshme, "Rregullat për Standardet Teknike për Beton dhe Beton të Armuar (PBAB). Të gjitha panellet (kalleet) e pjeseve të dukshme të betonit të lyhen dhe të jenë të kualitetit të lartë në mënyrë që të përmbushen edhe kriteret e lartë vizual-estetike të sipërfaqeve të betonit. Betoni për betonimin e mureve dhe shtytave të jashtme, prapa të çelave bëhen mbushje e argjinaturat dhe shtohet hidroizolimi vertikal me shtimin e aditivëve të papershkrueshëm nga uji. Kalleet dhe platformat mbështetja duhet të bëhen në bazë të dimensioneve të parashikuara në mënyrë të saktë dhe cilësore, në mënyrë që pas betonimit dhe çmontimit të punimeve të mos ndodhin as deformimi me i vogël në strukture. Gjatë betonimit strukturat konstruktive pas ndërprerjeve të nevojshme të betonimeve, lidhja dhe vazhdimi duhet të pastrohen së pari, sipërfaqja duhet të jetë e ashpër, shpëlarje dhe pastaj të betonohet vazhdimi. Llogaritja e sasive të punimeve të kryera në të vërtetë nga njësitë e dhëna të masës (libri i ndërtimit). Çmimi njësi i secilit pozicion të këtyre punimeve përfshin gjithçka që është e nevojshme deri në përfundim të së njëjtes.				
3.1	Furnizimi, transporti, dhe punimi i shtresës rratshuese të betonit të varfër nën themele të mureve në gropën e rregulluar me beton të vibruar dhe me aditive për papershkrushmeri të ujit d = 5 cm, Me C 12/15 Punimet të kryhen sipas detaje grafike të dhëna për kesi lloj punimesh.Llog në m3	m³	0.85	90.00 €	76.75 €
3.2	Punimi i kallupimit nga drasat për punimin e themelit shiritore të traveve përiferik Furnizimi, transporti, hudhja e betonit në veper e Betonit të klasit C -25/30 ,betoni duhet vibruar dhe shtuar aditive për papershkrushmeri të ujit dhe largimi i kallupimeve. Punimet të kryhen sipas standardeve dhe detajeve grafike të dhëna në llogaritjen statike.Llog në m3	m³	1.71	95.00 €	162.45 €
3.3	Punimi i kallupimit nga drasat me sipërfaqe të lënuara për punimin e pllakës d= 15 cm Furnizimi, transporti, hudhja e betonit në veper e Betonit të klasit C -25/30 ,betoni duhet vibruar dhe shtuar aditive për papershkrushmeri të ujit Punimet të kryhen sipas standardeve dhe detajeve grafike të dhëna në llogaritjen statike. Në çmim të parashifen edhe traret e mshfët neper muret egzistuese të objektit.Llog në m3	m³	2.92	95.00 €	277.36 €
Gjithsej punime të betonarnes:					516.62 €

IV PUNIMET E ARMIRUESJEVE					
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
	Të gjitha llojet e armaturave duhet të pastrohen nga ndryshku, balta dhe gëlqerja, prerja, lakimi dhe vendosja saktesisht sipas llogaritjes statike dhe detajeve të armaturës. Para betonimit, organi mbikqyrës duhet të kontrollojë vendosjen e saktë të armaturës. Çmimi njësi i secilit pozicion të këtyre punimeve përfshin gjithçka që është e nevojshme deri në përfundim të së njëjtes.Lloji i armaturave të përdorura janë Sipas detaleve në projekt: Armatura S-500;				
4.1	Furnizimi, punimi, prerja, lakimi, lidhja dhe ivendosja e armatures ne kallupe si GA, RA dhe MA sipas pozicioneve të projektit dhe detajeve statike. Armatura të tipeve GA,RA,MALlog në kg.				
	traret 30x30 cm	kg	98.00	1.50	147.00 €
	pllaka d= 15 cm me dim 616x316 cm	kg	156.00	1.50	234.00 €
Gjithsej punime të Armiruesjeve:					381.00 €

V PUNIMET E KONSTRUKSIONIT ME ÇELIK					
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej

5.1	Furnizimi , prerja, saldimi dhe punimi i objektit metalike sipas detajit ne projekt. Lartesia e objektit është deri ne H=3.00 m. Në pozicion të përfshihen , ankerimet e nevojshme,të shtyllave vertikale saldimit, shtyllat vertikale, horizontalet, shtangimet me profile çeliku ne diagonale , pllakat pastrimet si dhe , lercera me një ngjyrë antikorozion dhe dy shtresa finale nuanca e gjelbërt. Llogria në kg të konstruksionit. konstruksioni punohet sipas detajit teknike ne pershkrimin teknike.				
	pllakat mbeshjtelse #120x180x8 mm	kg	17.52	4.50	78.85 €
	shtylla vertikale □100x60x3 mm	kg	275.73	4.50	1,240.79 €
	traret horizontal □ 60x60x3 mm	kg	390.00	4.50	1,755.00 €
	traret horizontal mbajtes □100x60x4mm	kg	186.60	4.50	839.70 €
	brinjët horizontale □ 80x60x4mm	kg	240.60	4.50	1,082.70 €
	shtangimet dhe hulyjet kunder eres □ 40x40x3mm	kg	115.15	4.50	518.18 €
5.2	Furnizimi, prerja, saldimi dhe vendosja e deres hyrese dy krishe me dimensione (200x240 cm), te inkuadruar në shtyllat vertikale dhe trareve horizontal nga materiali dhe dizajni i meje si i panelat mbeshjtjellse te fasades. në çmim të llogariten ngjyrosja dhe mekanizimi për hapje dhe mbyllje, si dhe xhamat e deres. Llog në	copë	1	1000	1,000.00 €
Gjithesëj punime të konstruksionit metalik:					6,515.21 €

VI	PUNËT E FASADES SË DHE LLAMARINES				
POS	Pershkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Çmimi	Gjithesj
	Përveç pershkrimnit të artikujve individualë të punimeve, kontraktori përfshinë në çmime kushtet e mëposhtme të zakonshme. Punimet me llamarinë metalike do të behen në gjithcka sipas projektit, detajet dhe standardet e vlefshme. Çmimet përfshijnë të gjitha operacionet e punës dhe konsumin e materialit, si dhe njetet ndihmëse dhe skelat që përkrahajnë "Normat dhe standardet e punës në ndërtim".				
6.1	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i mbulimit konstruksionit të kulmit dhe mureve te objektit nga llamarina e plastifikuar me t=0.5mm e brinjëzuar dhe profiluar me panel sandwich termozolimi t=8 cm, sipas zgjidhjes arkitektonike. Në çmim të parashifet edhe punimi i strehes me elemente nga llamarina e plastifikuar. Ngjyren dhe dizajnin e përzgjedhë investitori. Llogaritja te bëhet në m² të sipërfaqes së projekcionit te pjertë.	m²	80.18	7.50 €	601.31 €
6.2	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i ullqeve horizontal nga llamarina e plastifikuara d = 0.55 mm me një gjerësi të zhvilluar sipas detajit arkitektonik deri 1.10 m. Në çmim përfshihet i gathe materiali i nevojshem lidhes, skelat dhe pajisjet për montim dhe instalim. Llogaritja te bëhet në m².	m²	6.00	7.50 €	45.00 €
6.3	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i ullqeve vertikale nga llamarina e plastifikuar me dimensione katrore 12x12cm me trashësi d=0.55mm. Në çmim përfshihen te gjitha elementet e nevojshme për realizimin e ketij pozicioni me elemente përcjellëse Kazam i ujembledhësu dhe kokat e ullqeve për shkarkim. Llogaritja te bëhet në m².	m²	3.50	7.50 €	26.25 €
6.4	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i nveshjes se mureve te kalikonit , të objektit me elemente adekuate nga llamarina e plastifikuar d= 0.55 mm me gjaësi te zhvilloar 0.50 m, sipas detajit arkitektonik. Në çmim përfshihet i gathe materiali i nevojshem lidhes, skelat dhe pajisjet për montim dhe instalim. Llogaritja te bëhet në m².	m²	15.50	7.50 €	116.25 €
Gjithesj punime të fasades dhe llamarinës:					788.81 €

VII	PUNËT E TJERA				
POS	Pershkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Çmimi	Gjithesj


7.1	Pornizimi me material, transporti si dhe punimi i ndriçimit me dy drita. Në çmim përfshihet i gjithë materiali i nevojshëm lullës, skelat dhe pajisjet për montim dhe instalim. Llogaritja të bëhet në komplet	komplet	I	10.00	10.00 €	✓
7.2	Pornizimi me material, transporti si dhe punimi i një ventilatori. Në çmim përfshihet i gjithë materiali i nevojshëm lidhës, skelat dhe pajisjet për montim dhe instalim. Llogaritja të bëhet në copë	copë	I	25.00	25.00 €	✓
7.3	Pastrimi, larja, dizinfektimi i gjithëmbarsheve hapësirave të brendshme të objektit pas përfundimit të punimeve. Materiali i cili pastronhet të largohet nga objekti. Llog në komplet	komplet	I	120.00	120.00 €	✓
Gjithsej punime të tjera :					155.00 €	✓

REKAPITULLIMI I PUNIMEVE [A/1]

I	PUNËT PËRGATITORE	370.00 €	✓
II	PUNËT DEMOLIMIT, PASTRIMIT, TOKËSORE DHE MBUSHJA	349.80 €	✓
III	PUNËT E BETONIT DHE BETONARMES	516.62 €	✓
IV	PUNIMET E ARMIRUESEVE	381.00 €	✓
V	PUNIMET E KONSTRUKSIONIT METALIK	6,515.21 €	✓
VI	PUNËT E FASADËS SË DHE LLAMARINËS	788.81 €	✓
VII	PUNËT E TJERA	155.00 €	✓
GJITHËSEJ PUNIME [A/1] :		9,076.44 €	✓

DISLOKIMI I GJENERATORIT

Të përfshihen: punimet tokësore dhe punimet elektrike të kryera në terren dhe në objekt, të cilat janë të nevojshme për realizimin e punës së planifikuar. Për punimet tokësore dhe punimet elektrike të kryera në terren dhe në objekt, të cilat janë të nevojshme për realizimin e punës së planifikuar, të përfshihen: punimet tokësore dhe punimet elektrike të kryera në terren dhe në objekt, të cilat janë të nevojshme për realizimin e punës së planifikuar.						
1	PUNIMET TOKËSORE DHE ELEKTRIKE					
POZ.	Pershkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej	
1.1	Punët përgatitore - përfundimtare duke përfshirë edhe organizimin e punës, bartjen e pajisjes dhe mekanizmit në teren. Në fund pastrimi i teretit nga mbeturinat e bëra gjatë punës.	ha	0.30	300.00	90.00 €	
1.2	Kujdesi i situar gjatë punëve në teren. Hapsira që do të pastronhet nga instalimet ekzistuese në tokësore ka mundësi me pasë edhe instalime tjera përpos atyre që janë të identifikuar. Për këtë hapsirë nuk ka dokumentacion teknik që i përshkruan instalimet në tokësore. Puntë kryesë është përgjegjësi në rast të ndonjë pasojë për shkak të ndonjë dëmtimi që mund të shkaktoj gjatë kryerjes së punimeve. Për këtë arsye puntë kryesë duhet të parashoh 15% shpenzime të papapara për të mbuluar shpenzimet shtesë nga vonesat e kujdesit të shtuar. Të përfshihet inkuizimi i hapsirës për identifikim e kabllorve elektrike	komplet	1.00	450.00	450.00 €	
1.3	Çvendosja e gjeneratorit të objektit të Shtepis së Shëndetit nga pozita ekzistuese deri në pozitën e re e cila është shënuar në vizatim. Në këtë pozicion duhet llogaritur edhe çvendosjen e kabllave nga gjeneratori deri të kuadri hyrës i kësaj kabllë që ndodhet në mur të objektit të transfuzionit. Të përfshihet përhapja e kabllave në terren dhe në objekt.	copë	1.00	550.00	550.00 €	
1.6	Koka kabllorike për të tri fazat për kablla të tensionit të mesë për montim të brendshëm	copë	2.00	25.00	50.00 €	
1.7	Shirit i zinkuar Fe/Zn 40x5mm	m	42.00	6.00	252.00 €	



1.8	Vazhdimi i kablës furnizuese të objektit të Shqipërisë së Shëndetit Vazhdimi duhet të bëhet me termokurësë gjegjëse në tokë në thellësi 1m nën tokë dhe në distancë (1.5 deri 2)m nga muret e objektit të Garazhit ku është i vendosur gjeneratori. Ky vazhdim duhet të shënohet në dokumentacion dhe një kopje duhet të dorëzohet murembajtjes së kësaj objekti. Llog. në copë	copë	1.00	120.00	120.00 €	✓
1.9	Hapja e kanaleve me dimensione (60x80)cm për kablla furnizuese të objekteve. Kanalet duhet të shtrihen sipas pozitës të dhënë në situacion.	m	19.20	15.00	288.00 €	✓
1.10	Shtirja e reres me trashësi 20cm në kanalet e mesiperme. Shtirja kryhet në harmoni me rregullat teknike dhe në hazi të detalit të dhënë për këtë kanal	m ³	4.80	7.00	33.60 €	✓
	Furnizimi transporti dhe montimi me gypa të PE të brinjëzuar me diametër Ø-100 mm(PEHD) të paisura me telin e çelikut, respektivisht litari me të cilin më vonë tërhiqet kablloja nëpër gyp Llog. në m	m ²	120.00	13.00	1,560.00 €	✓
1.11	Mbushja e kanaleve me dhë duke e ngjeshur në çdo 20cm Llog. në m ³	m ³	12.00	3.00	36.00 €	✓
1.12	Hecja e dheut të tepert dhe dërgimi në deponime e qytetit apo ndonjë vend tjetër që e cakton kontraktuesi Llog. në m ³	m ³	7.20	3.00	21.60 €	✓
1.13	Thyerja e betonit në hyrje të objekteve për depërtimin e kabllave deri të tabelat hyrje të objekteve. Pas vendosjes së kabllave duhet të mbyllet vend depërtimit me beton.	komplet	1.00	250.00	250.00 €	✓
	Porositja, furnizimi transporti dhe shtirja e mbrojtëses mekanike të kabllave tip GAL, dhe i shiritit paralajmërues "RREZIK TENSIONI" Shiriti vendoset 20cm pa perfunduar mbushja. përgjatë gjatësisë së kanalit Llog. në m	m;	40.00	0.20	8.00 €	✓
1.14	Furnizimi dhe vendosja e kabllave furnizuese PFOO(Cu) 4x70mm ² prej nga vendi ku vazhdohej deri te gjeneratorit. Seksioni i kabllot definohet saktësisht kur fillon zhvendosja pasi që nuk ka element gravues apo nuk shihet në kabllo. Llog. në m	m	125.00	11.00	1,375.00 €	✓
1.20	Vendosja e mbrojtësve nga plastika për kablla të shtirja në kanal. Mbrojtësi ka gjersi 40cm, form të shkronjes "V" të shtuar dhe vendoset mbi shtresë të reres.	m	40.00	0.50	20.00 €	✓
1.22	Furnizimi dhe punimi i elementeve vazhduese-MUF-ave për kabllot që do të vazhdohej-posicioni nënkupton përfundimin e vazhdimit me të gjitha elementet e nevojshme si dhe mbulimi i vendit Llog. në copë	copë	3	15.00	45.00 €	✓
1.23	Material tjetër i ineti i nevojshëm për përfundimin e punëve	komplet	1	250.00	250.00 €	✓
Gjithsejt Punime tokësore dhe elektrike :					5,099.20 €	✓
II MATJET DHE GARANCIONET						
POZ	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej	
2.1	Matja e sistemit të pertokzimit dhe mofitimi me shkruar				70.00 €	
2.2	Matja e rrezistences së izolimit për të gjitha kabllat e vendosura rishitazi				50.00 €	
2.3	Punimi i dokumentacionit teknik me të gjitha ndryshimet e bera gjatë punës				100.00 €	
2.4	Dhënia e garancioneve për punet e bera dhe materialin e përdorur për dy vjet				150.00 €	
Gjithsejt Punime matje dhe garancione :					370.00 €	✓

REKAPITULLIMI I PUNIMEVE [A/2]

I	PUNET E DHEUT DHE PUNET E ELETRIKE	5,099.20 €	✓
II	MATJET DHE GARANCIONET	370.00 €	✓
GJITHSEJ PUNIMET [A/2] :		5,469.20 €	✓

REKAPITULLIMI I DISLOKIMIT TË GJENERATORIT ELEKTRIK [A1+A/2]



A/1	GHITHËSEJ PUNIME [A/1]	9,076.44 €
A/2	GHITHËSEJ PUNIMET [A/2]	5,469.20 €
TOTALI +18% TVSH:		14,545.64 €

B	RREGULLIMI DHE RIPARIMI I KULMIT TË OBJEKTIT
---	--

I PUNËT PËR PREGATITORE					
POS	Pershkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Cmimi	Gjithsej
	Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtës dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësirë në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtës. Punishtja të rrethohet me tabela prej llamarinë dhe me konstruktion të përfortuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parashih edhe çkryqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikryqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve eksistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve. Për çdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikëqyrës dhe projektanti. Per secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjashme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.				
1.1	Sigurimi i punishtës. Sigurimi të bëhet përmes shenjave përkatëse të cilat krijojnë siguri dhe zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sa zgjasin punimet sipas kërkesave të investitorit. Llog. në komplet	komplet	1.00	150.00	150.00 €
